

V E N D I M
Nr.102, datë 5.3.1999

PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË FUNKSIONARËVE POLITIKË DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 12 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 " Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.810, datë 28.12.1998 "Për dhënien e fondeve buxhetore për skemën e trajtimit me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në kuptim të këtij vendimi, funksionarë politikë dhe nëpunës civilë të administratës së lartë shtetërore, që trajtohen me strehim të quhen:

- a) Anëtarët e Këshillit të Ministrave.
- b) Deputetët.
- c) Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese e të Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe çdo nivel i barazuar me ta.
- ç) Zëvendësministrit dhe personat e barazuar me ta, prefektët, kryetarët e këshillave të rretheve, kryetarët e bashkive, si dhe ushtarakët me gradën e gjeneralit.

d) Funksionarë të lartë shtetëror në ministri dhe institucione të tjera qendrore, të cilët përfshihen në lidhjen I (B1-B3) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.213, datë 28.3.1998.

2.Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të përmendur më sipër janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.

3. Trajtimi me strehim bëhet nëpërmjet sistemit të kredive nga fondet e depozituara për këtë qëllim nga buxheti i shtetit në llogari të veçantë pranë Bankës së Kursimeve. Në këtë llogari derdhen edhe arkëtimet nga vjelja e kredisë, të cilat përdoren nga Këshilli i Ministrave për të njëjtin destinacion.

4. Banka e Kursimeve do të përfitojë një komision në masë 1 përqind të vlerës së çdo arkëtimi. Kjo vlerë do të përdoret për të përballuar shpenzimet e operacioneve financiare të Bankës së Kursimeve për këtë veprimtari. Në këtë vlerë nuk përfshihen detyrime që mund të lindin për efekt të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave përmbartimore. Këto pagesa të bëhen nga fondi ose nga arkëtimet e kredive me miratim paraprak të Ministrisë së Financave.

5. Listat për marrjen e kredive nga funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhen me miratimin e Kryeministrit, pas kërkesës së motivuar të ministrive dhe të institucioneve përkatëse.

Listat për marrjen e kredive, sipas paragrafit të mësipërm, dërgohen në Bankën e Kursimeve nga Kryeministri.Banka respekton emrat dhe radhën e vendosur në këto lista nga Kryeministri.

6. Kredia jepet me vlerë deri në 5 milionë lekë me interes 3 përqind dhe afat kthimi deri në 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, që nuk kanë banesë deri në 2.5 milionë lekë me interes 3 përqind e afat kthimi në 15 vjet për ata që duan shtesë sipërfaqeje banimi.

7. Kredimarrësit paraqesin pranë Bankës së Kursimeve këto dokumenta:

Kërkesën personale

Çertifikatën e gjendjes familjare

Dokumentin identifikues

ç) Dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale.

Aktin e blerjes së banesës, vlerësimi i së cilës është bërë nga ekspertë vlerësues të liçensuar.

dh) Në rastin e ndërtimit të banesës paraqitet dokumentacioni sipas ligjit nr.8405,

datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

8. Ekzekutimi i kredisë të bëhet, pasi përfituesi i kredisë të vendosë për Bankën e Kursimeve me barrë hipotekare, banesën e blerë apo të ndërtuar me kredi.

9.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.487, datë 29.7.1998 "Për trajtimin me strehim të punonjësve të institucioneve buxhetore" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko